



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:106126
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05428184

E.nr.537/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përmbarrimit të kreditorit V.R.-J. nga Ferizaj të cilët i përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit QKMF - Ferizaj, për pagesën e shumës në emër të pagave jubilarë dhe shpenzimet e procedurës, më datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarrimore në lëndën E.nr.537/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.537/23, të datës 22/03/2023, e ka caktuar përmbarrimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit QKMF - Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit i plotfuqishëm 2021:106126, të datës 31.03.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarrimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 12/9/2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,489.72euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorë.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarrimore në këtë çështje juridike përmbarrimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.537/23, më datë 08.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi